



Ermela Guxholli
Nënkryetare

Perafrimi i kuadrit ligjor me standardet nderkombetare

Te nderuar zonja dhe zoterinj,

Kam kenaqesine e veçante te marr fjalen sot ne kete takim jubilar te nje vjetorit te krijimit te AMF. Nje date e tille nuk ka brenda vetem simboliken e rastit, por edhe nje vullnet te caktuar politik e institucional, si dhe nje numer jo te vogel perpjekjesh dhe energjish profesionale e monetare te shpenzuara, per t'i dhene jete nje projekti afatgjate qe ka per synim paresor, ngritjen e nje infrastrukture te qendrueshme kontrolli dhe monitorimi ne tregun tone financiar.

Ngritja e AMF nje vit me pare, ka qene nje sinjal i qarte i konsolidimit dhe standartizimit te tregut shqiptar. Kemi prekur me dore ne nje vit pune te perbashket, permasat e nje sfide jo te vogel, qe ka pasur si objektiv disiplinimin dhe maksimizimin e kapaciteteve te operatoreve financiare ne treg.

Zonja dhe zoterinj,

Zhvillimet e tregut financiar jobankar ne Shqiperi dhe nevoja e vendosjes se nje kuadri rregullash standarte per te gjitha institucionet qe ofrojne sherbime financiare, pergatiten kushtet per krijimin e Autoritetit te Mbiqyrjes Financiare, e cila u krijua nga shkrirja e tre autoriteteve mbikqyrese ekzistuese ne fushen e sigurimeve, titujve dhe pensioneve suplementare private.

Ky akt deshmoi se nuk ishte thjesht nje bashkim mekanik i enteve rregullatore ekzistuese, por nje proces qe kishte ne themelet e veta domosdoshmerine e percaktimit te politikave dhe procedurave te njejta licensuese dhe mbikqyrese per te gjitha institucionet financiare.

Te nderuar pjesemarres,

Ne themel te punes dhe perpjekjeve te Autoritetit te Mbiqyrjes Financiare qendron krijimi i nje tregu transparent dhe te hapur, ku operatoret mund te konkurojne me njeri tjetrin ne kushtet e nje kontrolli te balancuar nga rregullatori.

Ndryshimi i strukturës së rregullimit dhe mbikqyrjes së tregut financiar jobankar, bëri të domosdoshëm edhe ndryshimin e të gjithë kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi për fusha të ndryshme të këtij sektori. Në këtë kontekst, dispozitat e fundit të ligjit Nr. 9572 parashikojnë amendimet që u bëhen ligjeve përkatëse si dhe përcakton strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre. Më konkretisht, ndryshimet ligjore do të realizohen:

- | | | | |
|----|------------------------------|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. | në fushën e sigurimeve | - | ligji Nr. 9267, datë 29.7.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, ligji I Sigurimeve te detyrueshme motoreike. |
| b. | në fushën e letrave me vlerë | - | ligji Nr. 8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, |
| c. | në fushën pensioneve private | - | ligji Nr. 7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”. |

Në kuadër të implementimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me Bashkimin European (BE), gjatë vitit 2006 janë përgatitur ndryshimet e ligjit Nr. 9267,

datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, të cilat reflektojnë një aspekt shumë të rëndësishëm të direktivave të BE-së, lidhur me fondin e garancisë së shoqërive të sigurimit. Këto ndryshime konsistojnë në amendimin e nenit 98 për rritjen e fondit të garancisë në 3 milion Euro (€).

Me qëllim përgatitjen graduale të shoqërive të sigurimit për këtë ndryshim të rëndësishëm, rritja e fondit të garancisë është parashikuar të bëhet në tre faza: faza e parë përfundoi një muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, faza e dytë përfundoi më 30 shtator 2007, ndërsa faza e tretë dhe e fundit përfundon më 31 mars 2008.

Me gjithë skepticizmin që ndoqi procesin e miratimit të këtyre ndryshimeve, ato rezultuan të logjikshme, të mundshme për t'u arritur nga subjektet e tregut dhe të domosdoshme. Këto e vertetën faktin që gjatë periudhës që flasim, shoqëritë e sigurimit kanë përbushur 2 fazat e para të detyrimit ligjor për rritjen e fondit të garancisë. Implementimi i tyre është ndjekur me kujdes nga AMF.

Gjithashtu, mbështetur në detyrimin që buron nga dispozitat e Ligjit “Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare”, u ripanë të gjitha aktet nenligjore ekzistuese, të cilat u miratuan me ndryshimet përkatëse.

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm, që ka ardhur si nevojë e zbatimit të ligjit, është ndryshimi i afatit të dorëzimit të raportit vjetor të ekspertit kontabël të autorizuar nga shoqëritë e sigurimeve.

Ndryshimet në Kuadrin Rregullativ

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9572 datë 3.7.2006, “Për AMF”, u shfuqizuan të gjitha aktet nenligjore paralele, të cilat binin në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Për shmangien e vakumit të krijuar nga shfuqizimet e mësipërme, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e ligjit u hartuan dhe miratuan :

rregullat e brendshme të AMF, dhe
rregullorja e funksionimit të Bordit të AMF.

Si dhe janë miratuar një sërë procedurash e rregullash të brendshme të njesive të AMF-se si ato të procedurave të inspektimit, trajtimit të produkteve të reja që ndihmojnë se tepërmi në standartizimin e veprimtarisë.

Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, AMF, mbështetur në ndryshimet ligjore, rregullat e reja të miratuara, si dhe duke reflektuar nevojat e tregut, ka rishqyrtuar dhe miratuar të gjitha aktet nenligjore përkatëse, si me poshte:

10 rregullore në Fushën e Sigurimeve
7 rregullore në fushën e Letrave me Vlere si dhe
3 rregullore me fushën e pensiveve private

Për plotësimin e boshllekut ligjor në drejtim të procedurave licensuese dhe mbikqyrese të vlerësuesve të dëmeve dhe ndërmjetësve në sigurime, si dhe përmirësimit të investimit të provigjoneve, Bordi i AMF-së i ka propozuar Ministrisë të Financave për miratim nga Këshilli i Ministrave të tre projekt vendimeve të rëndësishme:

1. Projekt-VKM “Për kriteret dhe procedurat e licensimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime”
2. Projekt-VKM “Për kriteret dhe kushtet e licensimit të ndërmjetësve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e tyre”.
3. Projekt-VKM “Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimin e tyre nga shoqëritë e sigurimit”

Gjithashtu Bordi ka miratuar rregulloren në lidhje me risigurimet që sigurojnë përmirësime të cilësive së tyre. Aktualisht, në tregun e sigurimeve janë licensuar dhe operojnë vetëm agjentët në sigurime, por duke e konsideruar aktivitetin e ndërmjetësimit me të plote edhe me aktivitetin e

brokerimit, janë hartuar kriteret edhe për këto aktivitete. Nderkohe që për vleruesit e dëmeve nuk ka patur kritere të detajuara licensimi.

Gjithashtu, është miratuar Rregullorja “Për Regjistrin Elektronik On-line të shitjeve të policave të sigurimit motorik të detyrueshëm”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave për identifikimin dhe raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Policat e sigurimit të detyrueshëm motorik që janë subjekt identifikimi dhe raportimi sipas kësaj rregulloreje, janë policat për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, policat e kartonit jeshil dhe policat e sigurimit kufitar.

Hartimi dhe miratimi i rregullores së regjistrimit të licensuarve, ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së mbajtjes dhe ruajtjes së regjistrave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe lehtësimin e aksesit nga publiku.

Sot regjistrat mbahen në mënyrë elektronike dhe fizike. Ato janë të hapura për publikun, nepermjet publikimit të tyre në faqen e internetit të autoritetit.

Ka dalë Udhezimi “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”. Gjithashtu, AMF ka nxjerre udhëzimin “Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime”, si dhe ka krijuar një grup pune që po punon mbi hartimin e një ligji të ri sipas direktivave europiane dhe parimeve të IAIS mbi “Kontratat e përgjegjësisë së palëve të treta për sigurimin e detyrueshëm motorrik”.

Në fushën e pensioneve private po ndërmerren hapa për reforme ligjore, duke synuar hartimin e një kuadri të ri ligjor në përputhje me standartet ndërkombetare dhe direktivat e BE.

Kuadri licensues

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, duke respektuar kërkesat e ligjit “Për AMF”, dhe kërkesat e licensimit në zbatim të ligjeve të fushave (sigurime, letra me vlerë dhe pensione private suplementare) dhe akteve nënligjore, synon krijimin e një tregu financiar të drejtë, transparent dhe të barabartë.

Në procesin licensues të subjekteve që operojnë në tregun financiar jo-bankar, Autoriteti ka si parim bazë përcaktimin e kërkesave të qarta, objektive dhe transparente ndaj publikut.

Departamenti i Licensimit, në përputhje me politikën e AMF, ka qenë i vëmendshëm në procesin e analizës dhe mbikëqyrjes së kërkesave për blerjen e aksioneve nga shoqëritë e huaja, duke tentuar në investitorë me eksperiencë në fushën e sigurimeve dhe me gjendje financiare të larta. Futja në tregun e sigurimeve të investitorëve të fuqishëm si UNIQA-Austri, Vienna Insurance Group dhe ASPIS Grup, do të ndikojë në përmirësimin e cilësive të tregut të sigurimeve, nepermjet futjes së produkteve të reja, manaxhimit me të specializuar, përmirësimit të gjendjes financiare, me synim mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e besueshmërisë.

Kemi bindjen se ndjekja e politikave të qarta dhe zbatimi i kriterëve të licensimit për agjentët në sigurime do të sjellë pasojë pozitive për tregun.

Fillimi i veprimtarisë së tregëtimit në tregun me pakicë nga subjektet e licensuara, kërkon në mënyrë të domosdoshme edhe mbajtjen e regjistrimit të pronësisë së letrave me vlerë të Qeverisë nga subjektet e licensuara për këtë qëllim nga AMF.

Mbështetur në Ligjin Nr.8080, datë 01.03 1996 “Për Letrat me Vlerë”, në Rregulloren “Mbi licensimin e regjistruarve të letrave me vlerë” dhe Rregulloren “Për tregtimin me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së RSH”, janë licensuar në cilësinë e regjistruarve, 5 subjekte banka.

Lidhur me tregun e letrave me vlerë, përveç ndryshimeve të bëra Ligjit Nr. 8080, datë 01.03.1996 “Mbi letrat me vlerë”, AMF ka në proces një program bashkëpunimi me BERZH, lidhur me

hartimin e legjislacionit të nevojshëm dhe kuadrin rregullues mbi emetimin e bonove nga shoqërite aksionere.

Tregu i institucioneve të pensioneve private është gjithashtu pjesë e reformës, prandaj, Ligji mbi “Pensionet suplementare dhe Institucionet e Pensioneve Private” dhe aktet nën-ligjore që rrjedhin nga ky ligj janë duke u hartuar sipas reformës së qeverisë në sektorin e pensioneve.

Qeverisja e shoqërive të sigurimit

Në rritjen e rolit mbi qeverisjen e shoqërive të sigurimit, është synuar respektimi i kriterëve për të zgjedhurit në Këshillin Mbikëqyrës, në postet drejtuese apo komitetin e kontrollit, duke insistuar në rritjen e integritetit, profesionalizmit, eksperiencës dhe kualifikimit.

Struktura rregullative e tregut financiar jo-bankar ndryshoi me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9572, datë 3 Korrik 2006, “ Mbi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Megjithatë, ky ndryshim nuk ishte shoqëruar me infrastrukturen e duhur ligjore për të arritur detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj, prandaj rezultuan vështirësi në ndërveprimin me aktorët e tregut. Megjithëse Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka një status të pavarur, qëllimi i këtij institucioni rregullues është që të luajë një rol më aktiv drejt iniciativave dhe marrjes së masave rregulluese.

Eshtë rasti që në një vjetorin e AMF, të theksojmë edhe me fort atë çka solli edhe krijimin e këtij organizmi. Pra, nevojën që në procesin e ndërtimit të kësaj infrastrukture, të ketë një ndarje të qartë rolesh dhe përgjegjësish mes palëve të interesit, siç janë AMF-së, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, kompanitë e mbikëqyrura dhe organizatat e tjera. Ky proces do të shoqërohet me propozimin për ndryshimet ligjore dhe hartimin e legjislacionit të nevojshëm dhe duhet të synojë që secili prej këtyre aktoreve të njohë drejt të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, duke dhënë kontributin përkatës për konsolidimin e tregut financiar.

Perqasja dhe adaptimi i legjislacionit mbi të cilin operon AMF, me Direktiven e Bashkimit Europian, mbetet sfida jone kryesore, në fazën e dytë ku po hyn AMF, e që ka të bëjë me konsolidimin e saj të metejshëm.

Dhjetor, 2007